



KUVENDI

Bazuar në nenet 12 paragrafi 12.2 shkronja d dhe 14 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 10 paragrafi 1.5 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144, nenin 20 paragrafi 11 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 15 paragrafi 15.2 shkronja d dhe 17.1 të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës i Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2015, miratoi:

VENDIM

PËR DHËNIEN PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË KOMPANISË KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE – KEDS

Neni 1

Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS, për ndërtimin e Trafostacioneve të reja sipas planeve investive për zgjerim dhe përforcim të rrjetit distributiv, i jepen në shfrytëzim afatgjatë pronat e paluajtshme të Komunës, të evidentuara në:

- Certifikatën nr.182, pjesa e ngastrës kadastrale nr. 373, pronë publike në sipërfaqe prej 6.0m², Zona kadastrale Bellopojë,
- Certifikatën nr-385, pjesa e ngastrës kadastrale nr. 1422-0, pronë publike në sipërfaqe, 6.0m², Zona kadastrale Dumnicë e Poshtme.
- Certifikatën nr.242, pjesa e ngastrës kadastrale nr. 1776-0, pronë publike, në sipërfaqe prej 6.0m², Zona kadastrale Lupq i Poshtëm, dhe
- Certifikatën nr-79, pjesa e ngastrës kadastrale nr. 408-0, rrugë publike në sipërfaqe, 6.0m², Zona kadastrale Kunushec.

Neni 2

Paluajtshmëritë e cekura jepen për ndërtimin e trafostacioneve të reja TSSH 10(20)/0.4kv 160 (kvA) dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime të tjera.

Neni 3

Afati i dhënies në shfrytëzim është 40 (dyzet) vite.

Neni 4

Shfrytëzimi i pronave sipas këtij vendimi jepet pa kompensim.

Neni 5

Kontrata për dhënie në shfrytëzim të pronave sipas këtij vendimi nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfaqësuesi i KEDS-it.

Neni 6

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për raste të veçanta evidentohet në Regjistrin e të drejtave pronësore në elaboratin kadastral.

Neni 7

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit.

Neni 8

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-320- 70404
Podujevë,
31 korrik 2015



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi